

V E N D I M
Nr. 392, datë 15.8.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN NË
QARKUN E ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Elbasan në Qarkun e Elbasanit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme të cilët shpronësohen të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 14 604 m² tokë arë, 4 objekte të ndryshme me sipërfaqe 248 m², 56 m/l mure rrethuese, një pus uji, 90 m² servis mekanik, 54.2 m² magazinë bujqësore, 36 m² godinë në ndërtim, 189.73 m² objekt klinik dhe banesë 3 katëshe+nënçati, 1 118 rrënjë drurë frutorë dhe 728 m² rozmarinë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 49 426 358 (dyzet e nëntë milionë e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale është në shumën 815 000 (tetëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
5. Fondi prej 50 241 358 (pesëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e një mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.8.2002.
7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano